



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kuvendi

PROJEKT LIGJ<sup>1</sup>  
Nr. \_\_\_\_/2024

“PËR GJUE TINË”\*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- përcaktimin e rregullave e kërkesave për zhvillimin e gjetisë së qëndrueshme, si një veprimtari tradicionale, sportive, çlodhëse dhe turistike, si edhe për të mundësuar mbrojtjen e faunës së egër dhe ruajtjen e biodiversitetit;
- ofrimin e mekanizmave për menaxhimin e qëndrueshëm të gjetisë, duke e vlerësuar faunën e egër si pasuri kombëtare që administrohet dhe mbrohet me ligj;
- përcaktimin e masave për monitorimin dhe kontrollin me synim garantimin që parimet për gjetinë të zbatohen në mënyrë rigorozë, duke ruajtur tërësinë e ekosistemit dhe baraspeshën ekologjike;
- ç mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik dhe ekuilibrit ekologjik të habitateve natyrore, faunës së egër dhe florës së egër e të habitateve të tyre gjatë ushtrimit të gjetisë;
- respektimin e së drejtës së gjetisë dhe të të drejtave mbi gjahun, mbi trofetë e produktet e gjetisë dhe të tregimit të tyre;
- inkurajimin e përfshirjes së gjetarëve në monitorimin, menaxhimin dhe

<sup>1</sup> Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Rregulloren 3254/91 4 Nëntor 1991 që ndalon përdorimin e kurtheve në Komunitet dhe futjen në Komunitet të lëvozhgave dhe mallrave të prodhuara të llojeve të caktuara të kafshëve të egra me origjinë nga vendet që i kapin ato me anë të kurtheve ose metodave të kurthit që nuk përmbushin standardet ndërkombëtare humane të kurthit

kërkimin me qëllim përkujdesjen dhe ruajtjen e faunës së egër dhe të habitatit të saj;  
e) nxitjen e bashkëpunimit midis gjuetarëve dhe grupeve të tjerë të interesit në ruajtjen dhe menaxhimin e faunës së egër dhe të habitatit të saj.

## Neni 2 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Dhënia me qira e zonës së gjuetisë" është dhënia në shfrytëzim e zonës së gjuetisë, nëpërmjet procedurave të ofertës publike, personave fizikë apo juridikë.

2. "Guida gjuetie" janë personat fizikë, të aftë për të drejtuar grupet e gjuetarëve, duke lehtësuar transportin, lëvizjen, akomodimin e tyre dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin normal të gjuetisë në një tur gjuetie.

3. "Gjuetar" person i pajisur me leje gjuetie të vlefshme.

4. "Gjueti" është veprimtaria e specializuar e shfrytëzimit të faunës së egër, që ka të bëjë me ndjekjen, kapjen, vrasjen e kafshëve e të shpendëve, objekt gjuetie, me metodat e përcaktuara me ligj.

5. "Gjueti e qëndrueshme" është përdorimi i llojeve, objekt gjuetie dhe i habitateve të tyre në një mënyrë dhe sasi të tillë, që të mos shkaktojë pasoja të dëmshme afatgjata ndaj biodiversitetit dhe të mos pengojë ripërtëritjen e tij. Përdorimi i tillë krijon mundësinë e ruajtjes së biodiversitetit për të plotësuar nevojat e brezave të tanishëm e të ardhshëm dhe ruan mundësinë që gjuetia të konsiderohet si një aktivitet i pranueshëm social, ekonomik dhe kulturor.

6. "Kapaciteti i lejuar i zonave të gjuetisë" nënkupton:

a) sasinë maksimale të gjuetarëve, që mund të gjuajnë në një ditë, në një zonë të gjuetisë, duke respektuar rregullat e sigurimit teknik;

b) numrin e individëve të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, që mund të gjuhen në një ditë, në një zonë të gjuetisë.

c) sasinë e përcaktuar të lejeve të gjuetisë që lëshohen për zonat e ndryshme të gjuetisë.

7. "Kurth" nënkupton një mjet me qëllim mbajtjen ose kapjen e kafshëve përmes kapëseve të cilat mbyllen fort mbi një ose disa gjymtyrë, duke parandaluar këto gjymtyrë që të shpëputen nga kurthi.

8. "Lloje, objekt gjuetie" janë të gjithë llojet e egra të shpendëve dhe gjitarëve tokësorë gjuetia e të cilëve është e ligjshme.

9. "Lloje, objekt gjuetie, në kushte gjysmë të lira" është mbajtja e individëve të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, në kushte të krijuara artificialisht, ku ato ushqehen, kryesisht, me ushqime natyrore, por nuk kanë mundësi të lëvizin lirshëm jashtë kufijve të pjesës së izoluar të zonës së gjuetisë.

10. "Lloje, objekt gjuetie, në gjendje robërie" është mbajtja e individëve të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, në territore të rrethuara, ku ato nuk kanë mundësi të ushqehen me ushqime natyrore dhe të dalin nga këto territore.

11. "Manuali i gjuetarit" është tërësia e rregullave dhe e kërkesave, që karakterizojnë gjuetinë dhe figurën e gjuetarit.

12. "Menaxhuesi i zonës së gjuetisë" është personi fizik ose juridik, që menaxhon zonën e gjuetisë, sipas parashikimeve në dispozitat e këtij ligji.

13. "Metodikat e kapjes së gjahut për ripopullim" janë strategji dhe teknika që

përdoren për të kapur individë të specieve të ndryshme të gjahut, me qëllim që të rinovohet ose të ruhet popullata e këtyre specieveve.

14. “Ministria” është ministria përgjegjëse për gjuetinë.

15. “Ministri” është ministri që drejton ministrinë përgjegjëse për gjuetinë.

16. “Norma e gjahut” është sasia e individëve të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, e lejuar për t’u vrarë nga një gjuetar në një ditë gjuetie.

17. “Periudha e folezimit” është periudha në të cilën speciet lëshojnë vezët, kujdesen për to e më pas për të vegjlit, deri në mësimin e fluturimit.

18. “Periudha e riprodhimit” është periudha që përfshin periudhën e shumimit, të zënies së zonës së shumimit dhe të kujdesjes për të vegjlit, deri sa të ndahen nga nëna.

19. “Plani menaxhues” është dokumenti zyrtar, në bazë të të cilit bëhet menaxhimi i llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie dhe i zonës së gjuetisë.

20. “Plani vjetor i përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie” është dokumenti që, në përputhje me planin e menaxhimit të një zone gjuetie.

21. “Produkte të gjuetisë” janë objekte gjuetie të përfuara me anë të gjuetisë, të kapura gjallë, të therura, të rrjepura, pjesët e tyre, si mish e nënprodukte të tij, përfshirë trofetë e gjuetisë.

22. “Rezervate të mbarështimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie” është sipërfaqe jo më e vogël se 50 ha, që përdoret për kultivimin gjysmënatyror të një apo disa llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.

23. “Rikthimi në zonat e folezimit” është zhvendosja e përvitshme e shpendëve, në një ose më shumë faza, nga zonat e dimërimit në zonat e folezimit.

24. “Sezoni i gjuetisë” është periudha kohore gjatë së cilës lejohet gjuetia sipas llojit të faunës së egër, objekt gjuetie.

25. “Trajner” është personi i specializuar për stërvitjen e qenve të gjahut.

26. “Trofe të gjuetisë” janë pjesë të objekteve të gjuetisë të përpunuara, të fituara me anë të gjuetisë, të cilat shfrytëzohen për qëllime shkencore, estetike, kulturore dhe studimore.

27. “Zonë gjuetie” janë pjesë të sipërfaqeve tokësore dhe ujore, të shpallura si të tilla, ku jetojnë lloje të faunës së egër, objekt gjuetie dhe të cilat mund të shfrytëzohen për ushtrimin e gjuetisë.

28. “Zona të ripopullimit dhe të kapjes së gjahut për ripopullim” janë pjesë të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor, të paracaktuara për shtimin e popullatave të llojeve, objekt gjuetie.

Neni 3

### **Parimet e përgjithshme**

Rregullat e gjuetisë dhe të menaxhimit zbatohen në përputhje me këto parime:

a) Parimi i gjuetisë së qëndrueshme, gjuetia zhvillohet gjithmonë në përputhje me ruajtjen e biodiversitetit, integritetin e ekosistemit dhe balancën ekologjike;

b) Parimi i mbështetjes së përpjekjeve ruajtëse në një zonë të caktuar, gjuetia ushtrohet në përputhje me ruajtjen e popullatës së specieve në një nivel të kënaqshëm dhe që nuk cenon përpjekjet ruajtëse në zonën ku ato janë të përhapura;

c) Parimi i përdorimit të qëndrueshëm, gjuetia zhvillohet gjithmonë duke mbajtur parasysh luhatjet në popullatën;

ç) Parimi i kontrollit të balancuar ekologjikisht të specieveve, masat e marra duhet të jenë të përshtatshme ekologjikisht dhe në përputhje me problemin e shtruar për zgjidhje,

duke mbajtur parasysh statusin favorshëm për ruajtjen e specieve.

## KREU II

### LLOJET E FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUETIE

#### Neni 4

#### Llojet objekt gjuetie

1. Gjuetia ushtrohet vetëm mbi individë të llojeve të faunës së egër vendas ose migratorë, që jetojnë në gjendje të lirë në kushte natyrore apo që janë riprodhuar për t'u gjuajtur në territore të rrethuara, ose në gjendje gjysmë të lirë. Individët e llojeve të faunës së egërojekt gjuetie, miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për gjuetinë.

2. Nuk janë objekt i ushtrimit të gjuetisë dhe nuk lejohen të gjuhen individët:

a) e llojeve të faunës së egër, të mbrojtura nga konventat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) e llojeve të faunës së egër, që janë të rralla, të kërcënuara, në rrezik zhdukjeje dhe që bëjnë pjesë në listën e llojeve të mbrojtura;

c) e të gjitha llojeve të shpendëve të egër migratorë, të cilët, pas vlerësimit të popullatave të tyre, rezultojnë shumë të rrallë. Vlerësimi i llojeve migratore është pjesë e inventarizimit.

3. Përgjashtimisht, gjuetia e individëve të llojeve të ndaluaramund të bëhet në rastet:

a) e shtimit intensiv dhe të pakontrolluar të popullatës së një lloji;

b) e shfaqjes së situatave epidemike, zoonike në llojet e faunës së egër;

c) e shkakimit të dëmtimeve të vazhdueshme nga individët e një lloji.

4. Gjuajtja për rastet e përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, bëhet me autorizim të ministrit, në të cilin saktësohen lloji, sasia, zona e gjuetisë dhe koha e gjuetisë.

#### Neni 5

#### Gjuetia reduktuese

1. Gjuetia reduktuese zhvillohet vetëm kur popullata e një lloji të faunës së egër e lejuar për gjueti është shtuar dhe prish ekuilibrin e ekosistemit..

2. Njësia përgjegjëse për gjuetinë pranë njësisë së qeverisjes vendore, pas marrjes së informacionit për shtimin e popullatës së llojit të faunës së egër nga menaxhuesi i zonës, shoqatat e gjuetarëve dhe institucionet kërkimore shkencore, propozon gjuetinë reduktuese pranë ministrisë përgjegjëse për gjuetinë.

3. Gjuetia reduktuese kryhet me gjuetarë të pajisur me leje vetëm gjatë sezonit dhe me metodat e lejuara të gjuetisë, pas miratimit nga ministri.

4. Dokumentacioni, afati dhe procedura e miratimit të gjuetisë reduktuese miratohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjuetinë.

#### Neni 6

#### Gjuetia për qëllime kërkimore-shkencore

1. Gjahu për qëllime shkencore përfshin gjuetinë ose zënien e kafshëve të egra për hulumtime shkencore, për mësim universitar, për shumim të kafshëve për gjah ose për

qëllime të tjera didaktike.

2. Individë të llojeve të faunës së egër, që nuk janë objekt gjuetie, mund të gjuhen për nevoja të punës kërkimore-shkencore, me miratim të veçantë të ministrit përgjegjës për gjuetinë.

3. Gjuetia për qëllime kërkimore-shkencore bëhet pas marrjes së miratimit nga ministri.

4. Institucioni kërkimor-shkencor e realizon gjuetinë, duke angazhuar gjuetarë të pajisur me leje gjuetie. Në përfundim të gjuetisë, ai dorëzon në njësinë përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore dhe në strukturën përgjegjëse për gjuetinë pranë ministrisë raportin për rezultatet e arritura dhe të dhënat konkrete për individët e vrarë apo të kapur.

5. Dokumentacioni, afati dhe procedura e miratimit të gjuetisë për qëllime shkencore miratohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjuetinë.

#### Neni 7

### **Vrasja emergjente e kafshës së egër**

1. Vrasja emergjente kryhet në rastet kur:

a) kafsha e egër kërcënon dëmtimin e shpejtë dhe të rëndë të jetës së njerëzve. Në këtë rast, vrasja i njoftohet menjëherë njësisë përgjegjëse për gjuetinë pranë njësisë së qeverisjes vendore- përkatese dhe strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e gjuetisë.

b) kafshët bëhen vektor për sëmundje të transmetueshme, zoonoza, për të parandaluar rrezikun e transmetimit të sëmundjes tek njerëzit. Vrasja emergjente realizohet në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për veterinarinë, dhe autorizohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për veterinarinë dhe ministrit përgjegjës për gjuetinë.

### KREU III

### ZONAT E GJUETISË

#### Neni 8

### **Zonat e lejuara për gjueti**

1. Gjuetia zhvillohet vetëm në zonat e lejuara për ushtrimin e gjuetisë.

2. Zonat e gjuetisë përfshijnë fondin pyjor dhe kullosor jashtë territorit të zonave të mbrojtura, tokat bujqësore, sipërfaqet ujore të brendshme, toka të pafrytshme, të populluara me lloje të faunës së egër, objekt gjuetie.

3. Sipërfaqet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, përdoren për gjueti vetëm në rastet kur janë të përfshira në territoret e një zone konkrete, të lejuar për gjueti.

4. Zonat e lejuara për gjueti shtrihen në sipërfaqe që janë me pronësi shtetërore, private apo në përdorim të kombinuar dhe shpallen si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për gjuetinë.

#### Neni 9

### **Kriteret për krijimin e zonave të lejuara për gjueti**

Për krijimin e zonave të lejuara për gjueti mbahen parasysh këto kriterë:

a) zona e gjuetisë krijohet në sipërfaqe jo më të vogla se 500 ha, ndërsa zona për



kultivimin e llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, krijohet në sipërfaqe jo më të vogla se 50 ha;

b) zona të mos përfshijë vendbanime dhe qendra ekonomike, tregtare, arsimore, sportive e fetare dhe të ndodhet jo më pak se 300 metra larg prej tyre;

c) zona të jetë në vende, ku ushtrimi i gjuetisë nuk mbart rrezik për jetën, shëndetin dhe pronën e njerëzve;

ç) zona të jetë e populluar me llojet e faunës së egër, objekt gjuetie, që jetojnë natyrshëm apo që kultivohen në të;

d) zona të ketë kufij me vijimësi territoriale dhe në përputhje me relievin;

dh) numri i individëve të llojeve, që mund të jetojnë e kultivohen në atë sipërfaqe, të mundësojë gjuajtjen e tyre të programuar.

#### Neni 10

#### **Propozimi i zonës së gjuetisë dhe kufijtë**

1. Zonat e gjuetisë dhe kufijtë i propozohen ministrisë nga njësitë përgjegjëse për gjuetinë.

2. Propozimi përmban:

a) të dhëna mbi sipërfaqen, shtrirjen dhe kufijtë e saj;

b) koordinatat, hartën dhe skicat për planvendosjen;

c) kufijtë e një zone gjuetie të kenë vijimësi territoriale dhe të jenë në përputhje me relievin.

3. Mënyrat e shënimit të kufijve të zonës së gjuetisë miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjuetinë.

#### Neni 11

#### **Shqyrtimi i propozimit**

Struktura përgjegjëse për gjuetinë në ministrinë përgjegjëse për gjuetinë, shqyrton propozimin e ardhur duke mbajtur në konsideratë:

a) dokumentet e paraqitura nga njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore

b) përputhshmërinë e propozimit me kërkesat e këtij ligji;

c) përputhshmërinë e propozimit me politikat, strategjitë e planet e veprimit për mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit;

#### Neni 12

#### **Shpallja e zonës së gjuetisë**

1. Zonat e gjuetisë shpallen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për gjuetinë.

2. Pas shpalljes, koordinatat dhe hartat e zonave të lejuara për gjueti publikohen në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për gjuetinë dhe të njësisë përkatëse të qeverisjes vendore.

#### Neni 13

## **Heqja dhe rishikimi i statusit të zonës së gjuetisë**

1. Çdo zonë gjuetie humbet statusin:
  - a) për interesa të sigurisë kombëtare dhe për nevoja të mbrojtjes, i ndryshohet destinacioni i përdorimit të saj;
  - b) për nevoja të zhvillimit rajonal, i ndryshohet destinacioni i përdorimit të saj;
  - c) për shkak të përdorimit të keq dhe mbishfrytëzimit, zona humbet funksionet, për të cilat është krijuar;
  - ç) si pasojë e ndërhyrjeve të ligjshme, sipërfaqja e saj është zvogëluar nën minimumin e përcaktuar në ligj.
  - d) kur menaxhuesi i zonës nuk respekton kushtet e kontratës së qiramarrjes së zonës së ushtrimit të gjuetisë;
2. Heqja e statusit propozohet nga ministri përgjegjës për gjuetinë, bazuar në kërkesën e njësisë së qeverisjes vendore, dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.
3. Statusi për zonat e gjuetisë rishikohet çdo 5 vjet nga Ministria përgjegjëse për gjuetinë në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore përkatëse dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për gjuetinë.

### **Neni 14**

#### **Ndryshimi i kufijve të zonës së gjuetisë**

1. Kufijtë e zonës së gjuetisë ndryshohen në rastet kur:
  - a) një pjesë e territorit të një zone të miratuar bëhet i papërshtatshëm për gjueti për shkak të ndërrimit të destinacionit;
  - b) zona humbet vlerat ose funksionet për të cilat është shpallur;
  - c) kërkohet nga menaxhuesi i zonës.
2. Propozimi për ndryshim të kufijve të zonës së gjuetisë bëhet pranë Ministrisë përgjegjëse për gjuetinë nga njesia përkatëse e qeverisjes vendore.
3. Ndryshimi i kufijve të zonës së gjuetisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 15**

#### **Vendet e ndaluara për gjueti**

1. Ushtrimi i gjuetisë ndalohet në:
  - a) të gjitha sipërfaqet, që nuk përfshihen në zonat e gjuetisë;
  - b) në zonat e mbrojtura;;
  - c) kullotat dhe livadhet në fazën e korrjes;
  - ç) fushat e kultivuara për prodhimin e varieteteve të farave;
  - d) vreshtat e mbjella rishtazi;
  - dh) vreshtat nga krasitja deri në vjeljen e prodhimit;
  - e) sipërfaqet e mbjella me drithëra, nga 1 prilli deri në përfundimin e korrjes së tyre;
  - ë) sipërfaqet ligatinore bregdetare, që shërbejnë si habitate për shpendët migratorë;
  - f) sipërfaqet ku zhvillohet akuakultura;
  - g) parcelat eksperimentale;
  - gj) hapësirat detare;
  - h) zonat e shpallura si zona me rëndësi të veçantë për shpendët;
  - i) zonat urbane dhe industriale;
  - j) aeroportet, heliodromet me përjashtim të rasteve kur shpendët përbëjnë rrezik për

- sigurinë ajrore, rrugët dhe hekurudhat;
  - k) territoret e reparteve, të bazave e të instalimeve ushtarake;
  - l) varrezat dhe oborret e mbyllura;
  - ll) fidanishtet, pemishtet, vreshtat dhe kopshtet e destinuara për prodhim intensiv, në sipërfaqe deri në 100 ha, nëse janë të rrethuara, që pengon migrimin natyror të kafshëve të egra;
  - m) territore, ku vërtetohet prania e sëmundjeve me patogjenitet të lartë.
2. Sipërfaqet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, me përjashtim të atyre të përcaktuara në shkronjat “c”, “d”, “dh” dhe “e”, nuk mund të përfshihen në territoret e zonave për gjueti.
3. Ministria përgjegjëse për gjuetinë publikon në faqen e saj zyrtare koordinatat dhe hartat e zonave të lejuara për gjueti.

#### Neni 16

### **Zona të ripopullimit dhe të kapjes së gjahut për ripopullim**

1. Për shtimin e popullatave të llojeve të faunës, objekt gjuetie, krijohet zona të ripopullimit dhe të kapjes së gjahut për ripopullim.
2. Njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore, në zbatim të objektivave të ministrisë përgjegjëse për gjuetinë, paraqesin në ministri propozimet e tyre për shpalljen e zonave të ripopullimit në territoret që ato administrojnë.
3. Zona të ripopullimit shpallen territore të pyjeve dhe kullotave, jo më të vogla se 1 000 ha, ku popullatat e një ose disa llojeve, objekt gjuetie, rezultojnë të pakësuara ndjeshëm nga mbigjuajtja ose për shkaqe të tjera.
4. Krijimi i zonave të ripopullimit mbështetet në kërkesat si më poshtë:
- a) zona të ketë qenë tradicionalisht habitat i llojeve që do të ripopullohen;
  - b) sipërfaqja e saj të jetë biologjikisht e mjaftueshme për jetesën normale të llojeve;
  - c) zona të plotësojë kushtet për ushqim dhe riprodhim;
  - ç) shtimi dhe ripopullimi të bëhen me lloje vendase tradicionale;
  - d) të përcaktohen qartë në terren dhe në harta kufijtë e zonës.
5. Zonat e ripopullimit shpallen me urdhër të ministrit. Gjatë këtij afati, në këto zona gjuetia është e ndaluar.
6. Pas ripopullimit, këtyre zonave u hiqet statusi si zona të ripopullimit dhe mund të shpallen edhe si zona të lejuara për gjueti, duke zbatuar procedurat për shpalljen e zonave të gjuetisë, të parashikuara nga ky ligj.
7. Metodikat e kapjes së gjahut për ripopullim në zonën e shpallur për ripopullim, propozohet nga njësia e vetqeverisjes vendore dhe miratohet nga ministri përgjegjës për gjuetinë.

#### Neni 17

### **Rezervate të mbarështimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie**

1. Rezervate të mbarështimit shpallen territore të pyjeve dhe kullotave, jo më të vogla se 50 ha, në të cilat fauna e egër mbarështohet në gjendje gjysëm të egër me ndërhyrjen e njeriut me ushqim, me kushte strehimi e shumimi.
2. Krijimi i rezervateve të mbarështimit mbështetet në këto kritere:
- a) zona të ketë qenë tradicionalisht habitat i llojeve që do të mbarështohen;



- b) sipërfaqja e saj të jetë biologjikisht e mjaftueshme për jetesën normale të llojeve;
  - c) zona të plotësojë kushtet për ushqim dhe riprodhim;
  - ç) shtimi dhe ripopullimi të bëhen me lloje vendase tradicionale;
  - d) të përcaktohen qartë në terren dhe në harta kufijtë e zonës.
3. Rezervatet e mbarështimit shpallen me urdhër të ministrit.

#### Neni 18

### **Zonat për stërvitjen e qenve të gjahut**

1. Qentë e gjahut stërviten vetëm në zonat e lejuara për gjueti.
2. Gjuetarët dhe trajnerët respektojnë kufijtë e zonës.

#### KREU IV

### **STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR MENAXHIMIN E GJUETISË**

#### Neni 19

### **Strukturat përgjegjëse për gjuetinë**

Strukturat përgjegjëse për zhvillimin e gjuetisë së qëndrueshme janë:

- a) ministria përgjegjëse për gjuetinë;
- b) njësia përgjegjëse për gjuetinë e NJQV/ve;
- c) menaxhuesit e zonave të gjuetisë.

#### Neni 20

### **Ministria**

1. Ministria është institucioni më i lartë politikëbërës dhe rregullator, që garanton zhvillimin e qëndrueshëm të gjuetisë dhe menaxhimin e faunës së egër dhe të habitatit të saj.

2. Ministria, në përmbushje të rolit të saj ka këto përgjegjësi:

- a) përcakton drejtimitet e politikave për gjuetinë, duke garantuar harmonizimin me prioritetet kombëtare dhe politikat e tjera sektoriale që lidhen me mbrojtjen e faunës së egër.
- b) harton dhe përmirëson kuadrin ligjor rregullator në fushën e gjuetisë.
- c) harton programin kombëtar të zhvillimit të gjuetisë;
- ç) propozon periudhës së hapjes së sezonit të gjuetisë.

#### Neni 21

### **Njësia e qeverisjes vendore**

1. Njësia përgjegjëse për gjuetinë pranë njësisë së qeverisjes vendore është struktura vendore për zhvillimin e gjuetisë së qëndrueshme në nivel vendor.
2. Njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore, në përmbushje të rolit të saj ka këto përgjegjësi: :

- a) propozon shpalljen e zonave të gjuetisë, ripopullimit dhe mbarështimit të faunës së egër objekt gjuetie;
- a) menaxhon dhe kontrollon administrimin e zonave të gjuetisë, që janë në territorin e tyre dhe kryerjen e veprimtarisë së gjuetisë në to;
- b) kryen procedurat për dhënien në përdorim të zonave të gjuetisë;
- c) lidh kontratë me fituesin për dhënien me qira të zonës së gjuetisë;
- ç) organizon testimin e gjuetarëve në bashkëpunim me shoqatën dhe federatën e gjuetarëve;
- d) shqyrton kërkesat për leje gjuetie;
- dh) administron regjistrin e lejeve të gjuetisë;
- e) administron mandat pagesat për ushtrimin e gjuetisë;
- ë) grumbullon të dhënat vjetore të monitorimit të gjuetisë;
- f) miraton planin vjetor të përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, të propozuar nga menaxhuesi i zonës së gjuetisë.

## Neni 22

### **Menaxhuesi i zonës së gjuetisë**

1. Menaxhuesi i zonës së gjuetisë është personi fizik ose juridik që përzgjidhet sipas një procedure konkurrimi.
2. Kriteret për të përzgjedhur menaxhuesin e zonës së gjuetisë janë sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 28, të këtij ligji.
3. Menaxhuesit e zonave të gjuetisë në përmbushje të rolit të tyre, kanë këto përgjegjësi :
  - a) sigurojnë funksionimin e shërbimit profesional për zbatimin e planit menaxhues të gjuetisë dhe shërbimin e ruajtjes së gjahut;
  - b) organizojnë veprimtaritë e gjuetisë;
  - c) harton planin e menaxhimit dhe planin vjetor të përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.

## KREU V

### MENAXHIMI I GJUETISË

## Neni 23

### **Planet e menaxhimit të gjuetisë**

Menaxhimi i zonave të gjuetisë dhe i llojeve, objekt gjuetie, kryhet në bazë të:

- a) të programit kombëtar të zhvillimit të gjuetisë;
- b) të planit menaxhues të secilës zonë gjuetie;
- c) të planeve të menaxhimit të BE për speciet objekt gjuetie që ndodhen në një status të pafavorshëm ruajtjeje.

## Neni 24

### **Programi kombëtar i zhvillimit të gjuetisë**

1. Programi kombëtar i zhvillimit të gjuetisë pasqyron synimet dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të gjuetisë, metodat dhe rrugët për arritjen e tyre. Ai hartohet

nga ministria për një periudhë 10-vjeçare dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

2. Ministria, gjatë përgatitjes së këtij programi, këshillohet me ministrinë përkatëse e me shoqatën e gjuetarëve, si dhe siguron që programi të jetë në përputhje me planet e zhvillimit të territorit dhe me kërkesat e dokumenteve ndërkombëtare të kësaj fushe, ku vendi ynë është palë.

3. Ministria, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përgatit programin e parë kombëtar të zhvillimit të gjuetisë. Pas miratimit, programi kombëtar i zhvillimit të gjuetisë publikohet në faqen zyrtare të ministrisë.

## Neni 25

### **Përmbajtja e programit kombëtar**

Programi kombëtar i zhvillimit të gjuetisë është dokumenti shtetëror i cili përmban:

- a) synimet e politikave shtetërore për gjuetinë;
- b) kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm të gjuetisë;
- c) rrjetin e zonave të gjuetisë, në shkallë vendi;
- ç) llojet e faunës së egër, objekt gjuetie.

## Neni 26

### **Plani i menaxhimit të zonës së gjuetisë**

1. Menaxhimi i zonave të gjuetisë realizohet sipas planeve menaxhuese 10-vjeçare, të cilat i hartojnë menaxhuesit e zonave të gjuetisë për zonën që menaxhon secili.

2. Plani i menaxhimit përfshin:

- a) përshkrimin e zonës së gjuetisë;
- b) speciet objekt gjuetie të zonës;
- c) periudhën kohore të vlefshmërisë së planit;
- ç) përshkrimin e përgjithshëm të synimeve dhe objektivave të menaxhimit të faunës së egër, përfshirë ndikimin në speciet që nuk janë objekt gjuetie;
- d) përshkrimin e llojeve të habitateve;
- dh) përshkrimin e përmbledhur të historikut të përdorimit të tokës, transformimit të habitatit dhe menaxhimit të faunës së egër;
- e) të dhënat sasiore të shfrytëzimit të faunës së egër, kur këto të dhëna janë të disponueshme;
- ë) metodat e miratuara të studimit të zonës me qëllim përcaktimin e dendësisë së popullatave dhe metodat e monitorimit;
- f) metodën e miratuar për përcaktimin e niveleve të shfrytëzimit;
- g) rekomandimet për ruajtjen e habitatit për speciet përkatëse.

3. Plani menaxhues i zonës hartohet në përputhje me Programin Kombëtar të Zhvillimit të Gjuetisë, me planet e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, me kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të tokave bujqësore e me planet e rregullimit të territorit, si dhe marrëveshjet mbi objektivat për arritjen e Statusit të Favorshëm të Ruajtjes dhe të objektivave të tjerë përkatës.

4. Planet menaxhuese të zonave të gjuetisë miratohen Ministria përgjegjëse për gjuetinë.

5. Njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore ka të drejtë të kërkojë ndryshimin dhe përmirësimin e planit menaxhues të zonës së gjuetisë, ose të refuzojë miratimin e tij, kur nuk parashikon të gjitha elementet e pikës 2 të këtij neni.

6. Në kuadër të rishikimit të planit për shkak të ndryshimit të përhershëm dhe qenësor të

kushteve e të rrethanave, ku bazohet plani menaxhues 10-vjeçar i zonës, plani rihartohet në përputhje me kushtet e reja.

7. Deri në miratimin e planeve 10-vjeçare, menaxhimi i zonave të gjuetisë bëhet duke u mbështetur në planin vjetor të përdorimit të zonës së gjuetisë.

#### Neni 27

### **Plani vjetor i përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie**

1. Përpara çeljes së sezonit të gjuetisë, menaxhuesit e zonave të gjuetisë hartojnë planin vjetor të përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, pa të cilin gjuetia nuk mund të ushtrohet në asnjë zonë.

2. Plani përmban veprimet konkrete të menaxhuesit për:

a) përllogaritjet e përafërta për fondin, për kapacitetin e zonës, për mundësinë e gjuajtjes;

b) shtimin e popullatës së llojeve, objekt gjuetie;

c) ndërtimet, në dobi të llojeve të faunës së egër, si mjedise për të pirë ujë e çerdhe;

ç) mbjellje bimësh e sigurim ushqimi për llojet e egra, në periudha të vështira;

d) ndërtime në dobi të gjuetarëve, si pika vëzhgimi e ngrehina të thjeshta për ndenje;

dh) vendosje shenjash të kufijve, mirëmbajtje rrugësh e shtigjesh për gjuetarët.

3. Planet miratohen nga njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse brenda 20 ditëve nga dorëzimi për miratim. Miratimi i planeve të zonave përfundon një muaj para çeljes së sezonit të gjuetisë.

4. Menaxhuesit e zonave të gjuetisë paraqesin raport vjetor te pronari i zonës dhe njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, për përmbushjen e planeve vjetore.

5. Të gjitha veprimtaritë e menaxhimit janë në përputhje me planet vjetore menaxhuese të miratuara. Nëse, për shkak të fatkeqësive natyrore ose të rasteve të tjera emergjente, nuk mund të zbatohet plani vjetor menaxhues, menaxhuesi njofton menjëherë njësinë përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

6. Metodikat e hartimit të planeve të menaxhimit të zonave të gjuetisë dhe planeve vjetore të përdorimit dhe procedurat e miratimit të tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit.

#### KREU VI

### **DHËNIA NË PËRDORIM E ZONËS SË GJUETISË**

#### Neni 28

### **Dhënia në përdorim e zonave të gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit**

1. Zonat e gjuetisë i jepen në përdorim personave fizikë dhe juridikë nëpërmjet procedurës së konkurrimit publik sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

2. Dhënia në përdorim bëhet me kontratë qiraje për një afat jo më shumë se 10 vjet.

3. Menaxhuesi i zonës, për marrjen në përdorim të zonës së gjuetisë, duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

a) të jetë i regjistruar si person fizik/tregtar apo juridik;

b) të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore qendrore dhe detyrimet vendore;

c) të ketë një plan biznesi për menaxhimin e zonës së gjuetisë, duke përfshirë kushtet minimale dhe kërkesat e sigurisë si dhe investimet që do të bëjë në zonë.

4. Dokumentacioni, afatet dhe procedura e konkurrimit për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Për çdo rast të dhënies me qira të zonës së gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit njoftohet ministria përgjegjëse për gjuetinë.

6. Në rastin kur zona e miratuar e gjuetisë, mbarështimit dhe ripopullimit është pronë private, procedura e dhënies me qira apo përdorim bëhet sipas parashikimeve të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe njoftohet njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore.

#### Neni 29

#### **Vlera fillestare e qirasë**

1. Vlera fillestare për qiranë e zonës së gjuetisë përcaktohet sa 50 për qind e vlerës të gjuetisë vjetore të kafshëve të egra, të planifikuara sipas planit të përdorimit të llojeve të zonës së gjuetisë, të llogaritura sipas çmimit të tregut.

2. Vlera fillestare për qiranë e zonës së gjuetisë shërben si çmim dysHEME për personat që do të marrin pjesë në konkurrimin publik.

#### Neni 30

#### **Kontrata e qirasë**

Njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore lidh me fituesin kontratë për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, e cila duhet të përmbajë të paktën :

- a) emërtimin, madhësinë, kufijtë dhe infrastrukturën e zonës së gjuetisë;
- b) llojin dhe numrin e përafërt të kafshëve të egra, objekt gjuetie;
- c) masat për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e zonës së gjuetisë;
- ç) detyrimet për të investuar në zonë;
- d) formën, sasinë dhe afatin e pagesës së qirasë.

#### Neni 31

#### **Zgjidhja e parakohshme e kontratës**

1. Kontrata e qirasë mund të zgjidhet para përfundimit të afatit, për të cilin është lidhur, nëse:

- a) qiramarrësi nuk e përdor zonën e gjuetisë në përputhje me parashikimet e këtij ligj dhe me kërkesat e kontratës;
- b) për shkak të moszbatimit të masave të parashikuara në planin e menaxhimit, fondi i kafshëve të egra ka rënë nën minimumin e parashikuar në këtë plan;
- c) qiramarrësi nuk bën investimet e parashikuara dhe nuk i shfrytëzon ato për qëllime të përcaktuara në kontratë;
- ç) qiramarrësi nuk e paguan qiranë për dy herë radhazi, në masën dhe afatin e parashikuar në kontratë.

2. Në rastet e zgjidhjes së parakohshme të kontratës së qirasë, ekspertët konstatojnë gjendjen faktike të zonës së gjuetisë e të zbatimit të planit të saj menaxhues. Qiramarrësi detyrohet të bëjë kompensimin e dëmit real, të shkaktuar në zonë, sipas çmimeve të tregut.



3. Përcaktimi i vlerës reale të dëmit bëhet me akt ekspertimi, të hartuar nga ekspertë të pranuar nga të dyja palët kontraktuese ose të vendosura nga gjykata.

4. Në të gjitha rastet e zgjidhjes së parakohshme të kontratës së qirasë zhvillohet procedura e re e konkurrimit publik për dhënien e zonës së gjuetisë në përdorim. Deri në dhënien e saj në përdorim gjuetia ndalohet, ndërsa masat e kultivimit dhe të mbrojtjes së kafshëve të egra i merr pronari i zonës ose personi i autorizuar prej tij.

## KREU VII USHTRIMI I GJUETISË

### Neni 32 **Sezoni i gjuetisë**

1. Gjuetia ushtrohet vetëm brenda sezonit të hapur për gjueti duke respektuar periudhën e riprodhimit derisa të vegjëlit të ndahen nga nëna, dhe të folezimit derisa të vegjlit të mësojnë të fluturojnë, që përcaktohet sipas kritereve gjeografike, klimatike dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë. Për çdo vit, ministria publikon hapjen e sezonit të gjuetisë në faqen e saj zyrtare.

2. Kohëzgjatja e gjuetisë sipas llojeve, si dhe ditët e lejuara për gjueti, brenda sezonit të gjuetisë, caktohen me urdhër të ministrit.

3. Dita e gjuetisë fillon pas lindjes së diellit dhe përfundon me perëndimin e tij.

### Neni 33 **Gjuetari**

Gjuetar është personi fizik që plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetasë shqiptar;
- b) të ketë mbushur moshën 25 vjeç;
- c) të jetë i pajisur me leje për armë gjuetie;
- ç) të ketë fituar testin për çështjet teorike dhe praktike sipas parashikimeve në nenin 38 të këtij ligji që lidhen me veprimtarinë e gjuetisë;
- d) është pajisur me leje gjuetie;
- dh) njeh dhe respekton manualin e gjuetarit;
- e) merr pjesë në monitorimin dhe inventarizimin e faunës së egër të zonës së tij;
- e) është i padënuar për asnjë vepër penale e cila cënon jetën dhe shëndetin e njeriut.

### Neni 34 **Testimi i gjuetarit**

1. Personat, që synojnë të ushtrojnë gjuetinë, i nënshtrohen testimit të gjuetarit, sipas programit të miratuar nga ministria përgjegjëse për gjuetinë.

2. Programet e testimit hartohen nga ministria, në bashkëpunim me shoqatën e gjuetarëve e me strukturat universitare të biologjisë dhe përmbajnë njohuri teorike dhe praktike për veprimtarinë e gjuetisë e legjislacionin për të, për menaxhimin dhe përdorimin e llojeve, objekt gjuetie, njohuri për biologjinë e llojeve të faunës, për mënyrat, metodat dhe mjetet e gjuetisë, njohuri për armët e gjuetisë dhe përdorimin e tyre, për qentë e gjuetisë dhe për sëmundjet e llojeve, objekt gjuetie.

3. Shoqata dhe federata e gjuetarëve në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për

gjuetinë të njësisë së qeverisjes vendore, organizojnë testimin dhe formojnë komisionin e testimin, që funksionon në bazë qarku. Komisioni drejtohet nga përfaqësuesi i Shoqatës dhe Federatës dhe ka në përbërje përfaqësues të strukturave menaxhuese të pyjeve të njësisë së qeverisjes vendore, si dhe të strukturave universitare të biologjisë. Komisioni i testimin mblidhet një herë në vit, jo më vonë se një muaj para çeljes së sezonit të gjuetisë.

4. Personat që kalojnë me sukses testimin, pajisen me certifikatën e gjuetarit. Formati i certifikatës miratohet me urdhër nga ministri përgjegjës për gjuetinë.

#### Neni 35

### **Kërkesa për t'u pajisur me leje gjuetie**

1. Personat e testuar bëjnë kërkesë me shkrim për t'u pajisur me leje gjuetie nga njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së vetqeverisjes vendore të zonës, ku ka vendbanimin kërkuesi.

2. Kërkesa përmban gjeneralitetet e kërkuetit, zonën ku do të ushtrojë gjuetinë dhe kohëzgjatjen e ushtrimit të saj.

3. Kërkesa shoqërohet me këto dokumenta:

- a) certifikatën e testimin;
- b) lejen për mbajtjen e armës së gjuetisë;
- c) kartën e identitetit;
- d) mandat pagesën e tarifës së lejes.

4. Njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore shqyrton kërkesën me dokumentet sipas pikës 3, dhe brenda 5 ditëve pune nga marrja e tyre në dorëzim, vendos mbi miratimin apo refuzimin e kërkesës dhe njofton kërkuetin.

5. Në rast refuzimi të kërkesës për leje gjuetie, kërkueti ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Pas kalimit të këtij afati, kërkueti ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

#### Neni 36

### **Leja e gjuetisë**

1. Leja e gjuetisë është dokumenti, që i njeh të drejtën e ushtrimit të gjuetisë personit, që plotëson kushtet dhe kërkesat e këtij ligji. Formati i lejes së gjuetisë miratohet nga ministri.

2. Leja e gjuetisë është personale dhe e patransferueshme. Ajo mbahet nga gjuetari sa herë që ai shkon për gjueti dhe u paraqitet organeve të kontrollit, kur e kërkojnë.

3. Është i ndaluar çdo lloj aktiviteti gjuetie pa lejen e vlefshme të gjuetisë.

4. Tarifa e lejes përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak të njësisë përkatëse të qeverisjes vendore.

#### Neni 37

### **Format e lejes së gjuetisë**

1. Në varësi të vendit ku do të ushtrohet gjuetia, leja e gjuetisë jepet:

- a) në të gjitha zonat për gjueti të vendit;
- b) në të gjitha zonat për gjueti të qarkut ku banon gjuetari.

2. Në varësi të kohës kur do të ushtrohet gjuetia, leja e gjuetisë jepet për një afat 5-vjeçar

ose për një sezon gjuetie, në përputhje me kërkesën e gjuetarit

3. Në varësi të statusit të përshtatshëm të ruajtjes, leja e gjuetisë duhet të përfshijë listën e specieve objekt gjuetie si dhe metodat e lejuara të gjuetisë.

Neni 38

### **Regjistri i lejeve të gjuetisë**

1. Njësitë përgjegjëse për gjuetinë të njësisë të qeverisjes vendore administrojnë regjistrin e lejeve të gjuetisë, sipas formatit të miratuar nga ministri.

2. Në regjistrin shënohen leja e dhënë, emri dhe mbiemri i personit, të cilit i është dhënë leja, kohëzgjatja e saj dhe zona ku ushtrohet, ndëshkimet eventuale të dhëna për mbajtësin e saj gjatë sezonit të gjuetisë dhe heqja e lejes.

3. Regjistri i lejeve të gjuetisë publikohet në faqen e internetit të njësisë përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore dhe është i hapur për publikun.

Neni 39

### **Heqja e lejes së gjuetisë**

1. Leja e gjuetisë hiqet në çdo kohë kur mbajtësi i saj:

- a) bëhet, nga ana shëndetësore, i paafte për të ushtruar gjuetinë;
- b) ka dhënë dokumente apo të dhëna të falsifikuara për kërkimin e lejes;
- c) është ndëshkuar me masë administrative më shumë se dy herë;
- ç) është dënuar penalisht nga gjykata e krimeve të rënda;
- d) ia jep lejen një personi tjetër për ta përdorur;
- e) ka shkelur më shumë se dy herë kushtet e lejes së gjuetisë.

2. Organi kompetet për heqjen e lejes është njësisia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore që e ka lëshuar, pas shqyrtimit të shkeljes që ka evidentuar struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e gjuetisë, merr vendim për heqjen e lejes.

3. Ndaj vendimit për heqjen e lejes së gjuetisë, gjuetari mund të ankohet pranë titullarit të njësisë së qeverisjes vendore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Pas kalimit të këtij afati, gjuetari ka të drejtën e ankimit në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 40

### **Metoda, teknika dhe mjete të ndaluara në gjueti**

1. Është e ndaluar vrasja apo zënia e individëve të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, duke përdorur mjete dhe metoda të zënies ose të vrasjes në shkallë të gjerë dhe në mënyrë joselektive si:

a) helm dhe karrem helmuese ose trulllosëse duke nxjerrë kafshët nga strehat me gaz ose tym;

b) me mjete dhe metoda që shkaktojnë shkatërrim masiv duke përdorur kafshë të gjalla, të verbëra, ose të gjymtuara si karrem;

c) përdorimit të kurtheve me ledha dhe futjen e lëkurave/gëzofëve, dhe mallrave të përpunuara të disa llojeve të kafshëve të egra me origjinë nga vendet të cilat i kapin ato me anë të kurtheve ose kapjes apo metodave që nuk plotësojnë standardet ndërkombëtare njerëzore të kurthit/kapjes.

ç) eksplozivë, kurthe, gropa, gracka, ngjitës për shpendë, grepa, rrjeta, karrem të

helmuar ose mjete mashtruese;

- d) karrem të gjallë, të verbuar ose të sakatuar;
- dh) kuaj, qerre, automjete, barka me motor, që lundrojnë me shpejtësi mbi 5 kilometra në orë ose aeroplan për ndjekje;
- e) drita artificiale ose pasqyra ndriçuese;
- ë) pajisje elektronike për të përmirësuar pamjen në dritë të dobët;
- f) me pajisje elektrike dhe elektronike për vrasje ose trullosje me pajisje ndriçimi artificiale me pasqyra dhe pajisje të tjera verbuese;
- g) me pajisje ndriçimi të shënjestrës;
- gj) pajisje për imitim të zërit;
- h) rrymën elektrike për të vrarë ose paralizuar;
- i) tym ose gaz, që i detyrojnë kafshët të dalin nga vendet ku fshihen;
- j) rrrjetat për kapjen e shpendëve.
- k) armë automatike ose gjysmautomatike.

2. Gjuetari mund të përdorë qentë për ndjekjen e kafshës së plagosur, por nuk i lejon ata që ta mendojnë atë.

3. Gjuetarët, që plagosin gjitarë të mëdhenj, i ndjekin gjurmët e kafshës së plagosur e, nëse është e nevojshme, lajmërojnë menaxhuesin e zonës më të afërt të gjuetisë. 4. Ministria përgjegjëse për gjuetinë në përputhje me rregulloret e veçanta për mbrojtjen e faunës, natyrës dhe biodiversitetit, mund të lejojë përjashtimisht përdorimin e disa metodave, pajisjeve ose mjeteve të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni.

#### Neni 41

### Veprime të ndaluara në gjueti

1. Në territorin e Republikës së Shqipërisë ndalohet:

- a) gjuetia, pa qenë i pajisur me leje gjuetie;
- b) gjuetia e kafshëve dhe e shpendëve të egër, që nuk janë në listën e llojeve, objekt gjuetie;
- c) gjuetia jashtë zonave të lejuara të gjuetisë;
- ç) ushtrimi i gjuetisë në periudhën e ndaluar e jashtë sezonit të lejuar për gjueti;
- d) ushtrimi i gjuetisë me mjete, mënyra e metoda, që ndalohen nga ky ligj e nga aktet nënligjore në zbatim të tij;
- dh) vrasja e shpendëve në kohën kur u bien pendët, kur kanë ngrirë nga të ftohtit, si dhe kapja e kafshëve gjatë përmbytjeve;
- e) ushtrimi i gjuetisë në raste përmbytjesh, borë mbi 40 cm, ngricash, zjarri ose kushteve të tjera të jashtëzakonshme natyrore, që vështirësojnë dukshëm lëvizjen e kafshëve;
- ë) prishja e çerdheve, dëmtimi, mbledhja, marrja e vezëve dhe e të porsalindurve, vrasja ose nxjerrja nga strofka dhe shfarosja e atyre që ndodhen në të;
- f) vrasja e gjahut në kohën e riprodhimit dhe të rritjes së të vegjëlve;
- g) gjuetia gjatë periudhës së shumimit apo të kujdesit për të vegjlit dhe për llojet migratore, gjatë kthimit të tyre në territoret e shumimit;
- gj) vrasja ose kapja e individëve të llojeve, objekt gjuetie, mbi sasi të lejuara;
- h) gjuajtja gjatë natës, duke filluar me perëndimin e diellit deri në lindjen e tij;
- i) dëmtimi i rrethimeve, i ndërtimeve për gjuetinë, i vendeve të gjuetisë, i tabelave e shenjave të kufijve, i kullave të vrojtimit dhe i kafazëve të vendosur për zogjtë;
- j) tregtimi i specieve të gjalla ose të ngordhura për të cilat gjuetia dhe kurthet nuk

lejohen, përveç me një autorizimin specifik të Ministrisë;  
k) gjuajtja nga makina, mjetet e lundrimit dhe nga mjetet e fluturimit;  
l) mbajtja e armëve të gjuetisë të karikuara gjatë kalimit në qendrat urbane (në këmbë ose në makinë) dhe transporti i tyre të mbushura.

2. Kapja, vrasja, ose shfarsosja e llojeve të shpendit të Shqiponjës dhe popullatave të tyre, duke përfshirë vezët e tyre është e ndaluar në Republikën e Shqipërisë.

3. Kapja, vrasja, ose shfarsosja e faunës së egër dhe popullatave të tyre, duke përfshirë vezët e tyre, është e ndaluar:

1. në zonat e mbarështimit;
2. gjatë periudhës së mbylljes së sezonit të gjuetisë;
3. gjatë periudhave të ndalimit të përkohshëm të gjuetisë;
4. në zonat e ndaluara për gjueti ;
5. në kundërshtim me planin e menaxhimit të parashikuar në nenin x të këtij ligji.

3. Fauna e egër e kapur ose e vrarë duke përfshirë vezët e tyre, në kundërshtim me parashikimet e pikës 2, të këtij neni, konfiskohet nga:

a) njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore, në rastet kur shkelja ndodh jashtë zonave të gjuetisë;

b) menaxhuesi i zonës së gjuetisë, në rastin kur shkelja ndodh brenda zonës së gjuetisë.

#### Neni 42

#### **Armët e gjuetisë**

1. Gjuetia lejohet të kryhet vetëm me armë gjahu me leje të prodhuara për këtë qëllim dhe që plotësojnë kërkesat teknike të sigurisë.

2. Rregullat e mbajtjes, të ruajtjes dhe përdorimit të armës së gjahut me leje gjatë gjuetisë dhe në çdo kohë e vend tjetër miratohen me udhëzimin e përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Brendshëm.

3. Gjuetari i pajisur me armë gjahu të licencuar mund të mbajë thika dhe mjete të mprehta, si pajime të domosdoshme gjahu, që shërbejnë për gjueti.

#### Neni 43

#### **Deklarimi i gjahut**

1. Në përfundim të ditës së gjuetisë, gjuetari deklaron te menaxhuesi i zonës numrin e kafshëve e të shpendëve të vrara, duke i treguar ato, likuidon në vend pagesën për secilën dhe merr mandat-pagesën përkatëse.

2. Çdo gjuetar njofton dhe çon në qendrën më të afërt veterinare gjahun me shenja sëmundjeje.

#### Neni 44

#### **Pronësia e gjahut**

Gjahu i vrarë gjatë ushtrimit të gjuetisë i përket gjuetarit që e ka vrarë atë.

#### Neni 45



## **Trofetë e gjuetisë**

1. Trofetë e gjuetisë vlerësohen nga komisioni i vlerësimit të trofeve, që krijohet me urdhër të ministrit.

2. Komisioni i vlerësimit të trofeve përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët propozohen nga shoqata e gjuetarëve, fakultetet e biologjisë të universiteteve shtetërore dhe nga ministria përgjegjëse për gjuetinë. Në bazë të këtyre propozimeve, ministri miraton përbërjen e komisionit.

3. Komisioni i vlerësimit të trofeve vepron pranë ministrisë për një afat 10-vjeçar. Ai mblidhet sa herë që paraqiten kërkesa për shqyrtim dhe e shqyrton secilën brenda një muaji nga regjistrimi i saj në protokoll.

4. Për vlerësimin e trofeve të gjuetisë, kërkuesi paguan një tarifë prej 5 000 lekësh.

5. Funkcionimi i komisionit dhe dokumentet që ai administron bëhen sipas rregullores së organizimit dhe funksionimit të tij, që miratohet nga ministri.

### **Neni 46**

#### **Tregtimi i gjahut**

1. Personat fizikë dhe juridikë mund të tregtojnë individë të vvarë të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, pjesë të tyre dhe trofe nga gjuetia, të siguruar në mënyrë të ligjshme dhe kur ato figurojnë sipas listës së miratuar me udhëzim të ministrit dhe vetëm kur janë të pajisur me vërtetimin e lëshuar nga menaxhuesi i zonës së gjuetisë.

2. Individët e llojeve të faunës së egër, pjesët e tyre dhe trofetë e siguruar në mënyrë të paligjshme konfiskohen nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e gjuetisë..

3. Është e ndaluar tregtimi i lëkurave të kafshëve ose i të mirave të prodhuara prej tyre për llojet e specieve të mbrojtura, lista e të cilave, miratohet me urdhër ministri.

### **Neni 47**

#### **Shoqata dhe federata e gjuetarëve**

1. Shoqata e gjuetarëve, si bashkim vullnetar i gjuetarëve dhe federata, si bashkim shoqatash, formohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi "Për organizatat jofitimprurëse".

2. Federata përfaqëson bashkimin e shoqatave dhe mbron interesat e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Shoqata dhe federata kryejnë veprimtari që lidhen me trajnimin e gjuetarëve, me bashkëpunimin për ruajtjen e ekosistemeve dhe pasurimin e burimeve të gjuetisë, me mbrojtjen e mjedisit, kultivimin e etikës së gjuetarit dhe të traditave të gjuetisë.

### **Neni 48**

#### **Të drejtat dhe detyrat e shoqatës dhe federatës**

Në funksion të zbatimit të dispozitave të këtij ligji, shoqata dhe federata kanë të drejtat dhe detyrat si më poshtë:

- a) administrojnë regjistrin e anëtarëve të vet;
- b) marrin pjesë në testimin e gjuetarëve;
- c) japin mendim për krijimin e zonave të gjuetisë;
- ç) marrin pjesë aktive në përpunimin e politikave, të planeve të menaxhimit e projekteve për gjuetinë;

- dh) bashkëpunojnë me strukturat përkatëse në njësitë e vetqeverisjes vendore;
- e) organizojnë trajnime për të respektuar manualin e gjuetarit.
- ë) organizojnë kurse përgatitore për trajnimin e gjuetarëve.

## KREU VIII MONITORIMI DHE KONTROLLI

### Neni 49 **Monitorimi i gjuetisë**

1. Monitorimi i gjuetisë është proces i detyrueshëm, që kryhet nga njësia përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore dhe menaxhuesi i zonës së gjuetisë, e cila harton programet e monitorimit, përcakton metodat e grumbullimit të të dhënave e të përpunimit të tyre, si dhe ndjek zbatimin e tij.

2. Si pjesë përbërëse e monitorimit të faunës së egër, monitorimi i gjuetisë përmbledh monitorimin e veprimtarisë së gjuetisë dhe monitorimin e zonave të gjuetisë.

3. Strukturat menaxhuese të pyjeve dhe kullotave, struktura përgjegjëse inspektuese, njësitë tekniko-organizative të qeverisjes vendore, menaxhuesit e zonave të gjuetisë dhe shoqatat e gjuetarëve ndjekin në vijimësi zhvillimin e gjuetisë, duke nxjerrë të dhënat, sipas treguesve të përcaktuar në programin e monitorimit të gjuetisë.

4. Të dhënat vjetore të monitorimit grumbullohen në nivel qarku në njësinë përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore, e cila ia dërgon strukturës përgjegjëse për gjuetinë në ministri brenda muajit maj për vitin paraardhës. Struktura përgjegjëse për gjuetinë në ministri përpunon të dhënat e grumbulluara dhe rezultatet i publikon brenda muajit qershor në faqen e saj zyrtare.

### Neni 50 **Inventarizimi i llojeve, objekt gjuetie**

1. Popullatat e llojeve, objekt gjuetie, inventarizohen çdo vit në çdo zonë gjuetie, për të identifikuar sasinë e tyre, shtesën natyrale vjetore të popullatës së secilit lloj, si dhe për të planifikuar sasinë e individëve, që mund të gjuhen gjatë sezonit të ardhshëm në zonën konkrete. Në sezonin e ardhshëm nuk mund të planifikohen për t'u gjuajtur më shumë se 10 për qind e shtesës natyrale të popullatës së llojit.

2. Inventarizimi dhe regjistrimi i llojeve dhe popullatave të tyre kryhen në bashkëpunim me shoqatat e gjuetarëve dhe gjuetarët e zonës, nën drejtimin e menaxhuesit të saj, duke mbajtur parasysh kërkesat e veçanta të çdo lloji.

3. Menaxhuesit e zonave të gjuetisë, krahas grumbullimit të të dhënave për numrin e kafshëve të egra brenda zonës, grumbullojnë edhe të dhëna të tjera për gjendjen e kushtet e jetesës së kafshëve në zonën e gjuetisë dhe shënimet i dërgojnë në njësinë përgjegjëse për gjuetinë e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, e cila mban regjistrin e kafshëve të egra të zonave të gjuetisë.

4. Metodika e regjistrimit dhe inventarizimit të llojeve dhe popullatave të tyre, si dhe dokumentet e formatuara, ku pasqyrohen të dhënat dhe rezultatet e inventarizimit të llojeve, objekt gjuetie, miratohen me udhëzim të ministrit.

### Neni 51 **Kontrolli mbi gjuetinë**

1. Kontrolli mbi gjuetinë kryhet nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e gjuetisë në bashkëpunim me menaxhuesit e zonave të gjuetisë dhe me njësinë përgjegjëse për gjuetinë të qeverisjes vendore.
2. Kur organet e specializuara të kontrollit pengohen në kryerjen e detyrës, sipas pikës 1 të këtij neni, kërkojnë ndihmën dhe bashkëpunojnë me strukturat e Policisë së Shtetit e të Policisë Bashkiake.

Neni 52

### **Kontrolli doganor**

1. Importi, eksporti si dhe tranziti i faunës së egër, objekt gjuetie dhe përfshirë produktet e gjuetisë dhe vezët e tyre i nënshtrohen legjislacionit doganor në fuqi dhe legjislacionit në fuqi për tregtimin e llojeve të faunës së egër..
2. Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, për qëllime shkencore, kërkimore ose edukative, Ministria mund të lëshojë një leje për importin, eksportin ose tranzitin e faunës së egër, duke përfshirë vezët e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin e llojeve të faunës së egër.
3. Individë të vrarë të llojeve, objekt gjuetie, eksportohen, kur ato shoqërohen me vërtetim nga menaxhuesi i zonës së gjuetisë dhe me raport nga shërbimi veterinar.

KREU IX

### **SANKSIONET**

Neni 53

#### **Kundërvajtjet administrative**

Neni 53

#### **Kundërvajtjet administrative**

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor me gjobë, si më poshtë:

- a) gjuetia e kafshëve të egra, që nuk janë në listën e llojeve, objekt gjuetie sipas pikës 2 të nenit 4 dënohet me gjobë, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.
- b) gjuetia në zonat e ndaluara për gjueti sipas nenit 8, dënohet me gjobë, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.
- c) ushtrimi i gjuetisë në vëndet e ndaluara për gjueti sipas pikës 1 të nenit 15 dënohet me gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
- ç) ushtrimi i gjuetisë pa pasur me vete lejen e gjuetisë sipas pikës 2 të nenit 36, dënohet me gjobë, në masën 130 000 (një milion e treqind mijë) lekë..
- d) ushtrimi i gjuetisë pa pasur leje të vlefshme gjuetie sipas pikës 3 të nenit 36 dënohet me gjobë, në masën 400 000 (katërqind mijë) lekë.
- dh) vrasja apo apo zënia e individëve të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, duke përdorur mjete dhe metoda, teknika dhe mjete të ndaluara në gjueti sipas pikës 1 të nenit 40, dënohet me gjobë, në masën në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

- e) veprimet e ndaluara në gjueti sipas pikës 1 të nenit 41 dënohen me gjobë në masën 400 000 (katërqind mijë) lekë deri në 800 000 (tetëqind mijë) lekë.
- ë)kapja, vrasja apo apo zënia e individëve të llojeve të shqiponjës sipas pikës 2 të nenit 41, dënohet me gjobë, në masën në masën 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.
- f) kapja, vrasja ose shfarosja e faunës së egër dhe popullatave të tyre duke përfshirë vezët e tyre sipas pikës 3 të nenit 41 dënohet me gjobë në masën 1 000 000 (një milion lekë).
- g) ushtrimi i gjuetisë me armë, që nuk lejohet për t'u përdorur si armë gjuetie sipas pikës 1 të nenit 42 dënohet me gjobë, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë.
- gj) mosdeklarimi i gjahut të vrarë dhe mospagimi i tarifës për çdo individ të vrarë sipas pikës 1 të nenit 43, dënohet me gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 260 000 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.
- h) mosçuarja te veterineri i gjahut që dyshohet për sëmundje sipas pikës 2 të nenit 43 dënohet me gjobë, në masën 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë.
- i) tregtimi i paligjshëm i llojeve të faunës së egër, pjesët e tyre dhe trofetë e siguruara sipas pikës 2 të nenit 46 dënohet me gjobë, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.
- j) tregtimi i paligjshëm i i lëkurave të kafshëve ose i të mirave të prodhuara prej tyre për llojet e specieve të mbrojtura sipas pikës 3 të nenit 46, dënohet me gjobë, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.

#### Neni 54

#### **Dokumentimi**

1. Inspektimi dhe dënimi i shkeljeve bëhen nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e gjuetisë në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

2. Gjahu i vrarë ose i kapur konfiskohet, leja e gjuetisë i merret, ndërsa armët e mjetet e gjahut sekuestrohen dhe i dorëzohen me procesverbal Policisë së Shtetit. Arma e sekuestruar i kthehet gjuetarit sezonin e ardhshëm pasi të ketë paguar gjobën e përcaktuar.

3. Masat e konfiskimit të gjahut të vrarë, marrjes së lejes së gjuetisë dhe sekuestrimi i armës janë dënime plotësuese, që mund të jepen krahas dënimit kryesor me gjobë."

#### Neni 55

#### **Ankimimi dhe ekzekutimi i sanksioneve administrative**

Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj tij bëhen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin.

#### Neni 56

#### **Pagimi i gjobës**

1. Gjoha në zbatim të këtij ligji përbën titull ekzekutiv me përfundimin e shqyrtimit të ankimit administrativ sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe vendoset nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e gjuetisë në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin

2. Gjohat në zbatim të këtij ligji, paguhen brenda 30 ditëve.

Në rast mosekzekutimi vullnetar, për ekzekutimin e saj ngarkohet zyra e përbarimit sipas

rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative. Gjuetarit nuk i kthehet leja dhe arma e gjuetisë pa paguar më parë gjobën.  
3. Të ardhurat që vijnë nga ekzekutimi i vendimit të dënimit me gjobë derdhen në Buxhetin e Shtetit.

## KREU X DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

### Neni 57 **Akte nënligjore**

Brenda 2 viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore në zbatim të pikës 4, të nenit 8, pikës 1, të nenit 12, pikës 1, të nenit 24, pikës 4, të nenit 28 dhe pikës 1, të nenit 32 dhe ministri përgjegjës për gjuetinë miraton aktet nënligjore në përputhje me parashikimet e pikës 4, të nenit 5, pikës 5, të nenit 6, pikës 3, të nenit 10, pikës 3, të nenit 24, pikës 6, të nenit 27, pikës 2, të nenit 32, pikës 4, të nenit 34, pikës 1, të nenit 36, pikës 1, të nenit 38, pikës 5, të nenit 45, pikës 1 dhe 3, të nenit 46 dhe pikës 4, të nenit 50.

### Neni 58 **Dispozita kalimtare dhe Shfuqizime**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë” shfuqizohet.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 60/2022 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.
3. Deri në përzgjedhjen e menaxhuesit të zonës së gjuetisë sipas procedurës të përcaktuar në këtë ligj, të gjithë të drejtat dhe përgjegjësitë e menaxhuesit, delegohen tek struktura përgjegjëse për gjuetinë e NJQV-së përkatëse.

### Neni 59 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.8.2025

**KRYETARI**

**Elisa Spiropali**